

**Raporti Vjetor për vitin 2013 i
Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK)**

Shkurtesat:

DAK- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

TVK- Trupa për Vlerësim të Konformitetit

EA- Korporata Evropiane e Akreditimit

IAF- Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit

ILAC-Korporata Ndërkombëtare e Laboratorëve të Akredituar

OECD-Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik

MAC- Komiteti për Marrëveshje Multilaterale

BLA- Komiteti për Marrëveshje Bilaterale

LT- Laborator Testues

TI- Trupa Inspektues

TÇ- Trupa Çertifikues

SK- Standard Kosovar

ISO- Organizata Ndërkombëtare e Standardeve

EN- Standard Evropian

IEC- Komisioni Internacional e Elektroteknikës

EA GA Asambleja Gjenerale e EA

IPA- Instrumenti për asistencë për para anëtarësim në Evropë

CPD- Direktivat për produktet e ndërtimit

CPR- Rregulloret për produktet e ndërtimit

CROLAB- Shoqata e laboratorëve e Kroacisë

PT-Testet e zotësisë

ILC- Krahasset ndër laboratorike

PTB – Instituti Kombëtar i Metrologjisë, Gjermani

MoU- Marrëveshje Mirëkuptimi

DPA- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës

IARM- Instituti i Akreditimit i Republikës së Maqedonisë

TURKAK- Agjencia e Akreditimit e Turqisë

HAA- Agjencia Kroate e Akreditimit

RENAR- Asosacioni Rumun i Akreditimit
 MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
 KA- Këshilli i Akreditimit
 KPA- Këshilli Profesional i Akreditimit
 KT- Komitetet Teknike
 IC- Infrastruktura e Cilësisë
 UA- Udhëzim Administrativ
 MC- Manuali i Cilësisë
 SMC- Sistemi i menaxhimit të Cilësisë
 PT- Procedura Teknike
 PM- Procedura të Menaxhimit
 FO-Forma
 SH.P.K- Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Shkurtesat:.....	1
Hyrja	3
Misioni DAK-ës,.....	3
Vizioni DAK-ës,	3
Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të DAK	4
Fjala e Drejtorit të Drejtoratit për Akreditim dhe Zhvillim në DAK.....	4
II. Struktura organizative e DAK-së	5
Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës	6
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës	6
Drejtorati i Akreditimit dhe i Zhvillimit	6
Sektori i Akreditimit të Laboratorëve Testues, Trupave Inspektues dhe Certifikues, Menaxheri i Cilësisë	7
III. Aktivitetet e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK).....	7
Aktivitetet kryesore të DAK-së	8
Arritjet e DAK-së.....	8
IV. Objektivat dhe Aktivitetet në të ardhmen	11
Bashkëpunimi me organizmat qeveritar të vendit	12
Bashkëpunimi në nivelin Evropian dhe Ndërkombëtarë i DAK-së.....	12
Trajnimet e organizuara nga DAK.....	13
Takimet rajonale të DAK-ut	15
Aktivitetet e tjera të DAK-së	15

Hyrja

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) është institucion i vetëm shtetëror i themeluar me ligj, i pavarur në marrjen e vendimeve për akreditimin e laboratorëve testues/kalibruës, trupave inspektues dhe certifikues. Aktivitetin e saj e ka filluar si Njësi e Akreditimit në vitin 2008 dhe ka funksionuar në bazë të Ligjit Nr. 02/L-43 “Për Akreditim” si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2006/15.

Tani veprimtaria e Drejtorisë së Akreditimit bazohet në Ligjin Nr. 03/L-069 datë 13.12.2008 dhe amendamenti i ligjit të ri Nr. 04/L-007, 28.06.2011 “Për Akreditim”. Funksionalizimi i DAK-ut është bërë në bazë të UA Nr 2009/02 “Për organizimin e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës”.

Baza ligjore për funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës është :

- Ligji i Akreditimit Nr. 03/ L- 069 (amendamenti i ligjit të ri Nr.04/L-007)

Aktet nënligjore:

- UA Nr. 02/2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit”;
- UA Nr. 04/2013 “Përcaktimi i tarifave për Akreditim”;
- UA Nr. 01/2011 “Për formimin dhe rregullimin e veprimtarisë së Këshillit të Akreditimit”;
- UA Nr. 19/2012 “Për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimin e Emblemës së akreditimit”;
- Rregullorja e Këshillit Profesional;
- Rregullorja e punës për Komitetet Teknike;
- Rregullorja për përzgjedhjen e ekspertëve teknik

Dhe 104 dokumente (Manuali i Cilësisë, Procedura të menaxhimit, Procedura teknike, forma etj.) tjera të cilat mundësojnë që DAK të funksionoi sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17011.

Aktiviteti i Drejtorisë së Akreditimit përveç kësaj pakete ligjore, bazohet edhe në standardet ndërkombëtare për fushën e akreditimit dhe në dokumentet tjera të dala nga: EA (European co-operation for Accreditation), rregulloret e IAF (International Accreditation Forum), ILAC (International Laboratory Accreditation Cooperation) dhe rregulloret e Komisionit Evropian 764/ 2008 dhe 765/2008.

Adresa aktuale e Drejtorisë së Akreditimit është:

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Rr. “Muharrem Fejza”, p.n, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 36 563/36 572/36 602 /36 518

Fax: +381 (0) 38212807

www.dak-ks.org

Misioni i DAK-ës, është t’ju ofrojë të gjitha palëve të interesuara, akreditimin mbi bazën e rregullave të përcaktuara në ligje, standarde, rregullat teknike dhe në parimet e akreditimit.

Vizioni DAK-ës, është të bëhet anëtar firmosës i marrëveshjeve të njohjes reciproke me EA dhe të marrë pjesë aktive në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit. Me këtë rast do të

njiheshin certifikatat e vlerësimit të konformitetit nga të gjitha shtetet nënshkruese të MLA-së si shtetet anëtare të ILAC dhe IAF e në të cilat DAK është anëtare.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të DAK



MSc. Osman Hajdini

Të dashur lexues dhe klientë,

Viti që lamë pas ishte një vit angazhimi dhe vit i sukseseve në vazhdimësi i Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK).

Me ristrukturimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Drejtoria e Akreditimit u avancua në organ Qendrorë dhe atë si Drejtori e Përgjithshme e Akreditimit.

DAK pret që gjatë viteve në vijim të plotësohet vazhdimisht edhe me staf të ri, profesional dhe kompetent me qëllim të kryerjes së detyrave dhe obligimeve në fushën e akreditimit.

DAK edhe me tutje vazhdon të punojë mbi bazën e zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) dhe ngritjen e

skemave të reja të akreditimit sipas kërkesave të klientëve. DAK vazhdon ta mirëmbaj në mënyrë kontinuale si dhe të përcjellë funksionimin e SMC në përputhje me kërkesat standardit ISO/IEC 17011. I gjithë ky angazhim kontribuon në avancim të përgjithshëm të Infrastrukturës së Cilësisë në Kosovë me të vetmin synim që të plotësohen të gjitha kërkesat e konsumatorit. Avacimi i akreditimit si një nga tri shtyllat kryesore të Infrastrukturës së Cilësisë do të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së Kosovës dhe rritjen e eksportit.

Fjala e Drejtorit të Drejtoratit për Akreditim dhe Zhvillim në DAK



MSc Ibush Luzha

I dashuri lexues:

Drejtorja e Akreditimit e Kosovës (DAK) edhe vitin 2013 e përmbylli me sukses. Kjo dëshmohet edhe me rritjen e numrit të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit të cilat u akredituan gjatë vitit 2013, si rrjedhojë e punës intensive të stafit të DAK-së dhe interesimit gjithnjë e më të madh të sektorëve të biznesit për t'u akredituar. Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës si dhe ofrimi i shërbimit gjithnjë e më të mirë dhe me kompetencë profesionale u arrit në saje të trajnimeve të ndryshme preformancës që stafi i DAK-së pati deri më tani.

Kjo performancë e nivelit të duhur u tregua si gjatë vlerësimeve ashtu edhe gjatë mbikëqyrjeve që DAK pati gjatë vitit 2013. Gjithashtu DAK i kushtoi rëndësi të veçantë edhe identifikimit dhe eliminimit të mangësive të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.

Për ta përmirësuar vazhdimisht performancën, DAK i kushtoi rëndësi të veçantë kërkesave të klientëve, andaj gjatë vitit 2013 aplikoi dialog të hapur dhe konstruktiv me konsumatorët dhe palët e interesit. Të gjitha këto kontribuojnë në menaxhimin e rrezikut, ndihmojnë në


identifikimin e çështjeve emergjente, dhe gjetjen e mundësive për përmirësimin në vazhdimësi të shërbimeve dhe të performancës së DAK.

Krahasuar me vitet e tjera, DAK ka pasur një progres dukshëm më të madh, gjë që ceket edhe nga vlerësues të OECD-së (Organisation for Economic Co-operation and Development) të cilët vlerësuan se në fushën e akreditimit u arrit progres i dukshëm, duke cekur se vlerësimi fillestar i EA për DAK, ishte një instrument i shkëlqyer për progres. Këtë vit u mor vendim nga ana e EA –MAC (Komiteti për Marrëveshje Multilaterale) që DAK-ut ti bëhet vlerësimi i plotë. Nëse edhe ky vlerësim do të jetë i suksesshëm sikurse i pari DAK do të nënshkruan MLA (BLA), marrëveshjen multilaterale me EA (European co-operation for Accreditation) dhe me atë rast certifikatat që do të lëshojnë TVK-të e akredituara nga DAK-u do të njiheshin në tërë Evropën e edhe në botë pasi që EA ka marrëveshje me IAF (Organizata Botërore e Akreditimit) dhe ILAC (Organizata Ndërkombëtarë e Laboratorëve të Akredituar), e që DAK është anëtare e të dy organizatave. Një sinjal tjetër pozitiv është fakti që numri i krye-vlerësuesve, vlerësuesve dhe eksperteve është rritur që prej vlerësimit të fundit. DAK tani ka 7 krye vlerësues, 10 vlerësues dhe 36 ekspert.

Angazhimi maksimal, vlerësimi i pavarur, profesional dhe me kompetence do i mundësoj DAK-së pranimin e vlefshmërisë të sistemit të akreditimit si në rajon dhe me gjerë dhe kjo do ti kontribuoj ekonomisë dhe shoqërisë Kosovare.

II. Struktura organizative e DAK-së

Organograma:



Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) ofron shërbimin e akreditimit të:

- Laboratorëve testues dhe kalibrues;
- Trupave certifikues të sistemeve të menaxhimit;
- Trupave certifikues të personelit;
- Trupave certifikues të produkteve;
- Trupave inspektues;
- Trupave që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndër-laboratorike;
- Trupave që prodhojnë materiale referuese të certifikuara etj.;
- Përfaqëson Republikën e Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare dhe Evropiane të Akreditimit;
- Bashkëpunon me Organizatat Kombëtare të Akreditimit të vendeve e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, apo për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- Këshillon administratën shtetërore për çështje që lidhen me Akreditimin dhe Vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike;
- Mban, përditëson dhe jep të dhëna për statusin e Akreditimit të Trupave të Akredituara;
- Bashkëpunon me Infrastrukturën e Cilësisë me Ministrinë përkatëse, me Laboratorët Testues, Trupat për vlerësim të konformitetit dhe me shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit;
- Kryen trajnime në Fushën Akreditimit;
- Ndërmerr veprimtari në fushën e krahasimeve ndër-laboratorike dhe të testeve të zotësisë;
- Merr të dhëna nga Organet Akreditues të vendeve të tjera për Trupat e Akredituar prej tyre, të cilët kryejnë veprimtari në Kosovë;

Drejtorati i Akreditimit dhe i Zhvillimit

Drejtorati i Akreditimit është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe është përgjegjës për mirëvajtjen e procedurës së akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues të akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025, laboratorëve medicinal sipas standardit ISO/IEC 15189 dhe Trupave Inspektues dhe Certifikues sipas standardeve SK ISO/IEC 17020, SK EN 45011, SK ISO/IEC 17021, SK ISO/IEC 17024.

Drejtorati i Akreditimit dhe i Zhvillimit është përgjegjës për organizimin e trajnimeve sipas planit vjetor të trajnimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe atë sipas kërkesave të standardeve: SK ISO/IEC 17011, SK ISO/IEC 19011, SK ISO/IEC 17025, SK ISO/IEC 17020, SK EN 45011 SK ISO/IEC 17021, SK ISO/IEC 17024, SK ISO/IEC 15189, SK ISO/IEC 17043 etj. Drejtorati i Zhvillimit mbikëqyr Sektorin e Akreditimit të Laboratorëve Testues, Trupave Inspektues dhe Certifikues dhe Sektorin e Trajnimeve dhe Komunikimit me Organizatat Ndërkombëtare.

Drejtorati i Akreditimit dhe i Zhvillimit udhëhiqet nga Drejtori i Drejtoratit për Akreditim dhe Zhvillim, i cili i raporton Drejtorit të përgjithshëm të DAK-së.

Sektori i Akreditimit të Laboratorëve Testues, Trupave Inspektues dhe Certifikues, Menaxheri i Cilësisë

Sektori për Akreditimin e Laboratorëve është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe është përgjegjëse për mirëvajtjen e procedurës së akreditimit të laboratorëve testues, kalibruar sipas standardit ISO/IEC 17025 si dhe laboratorëve medicinal sipas standardit ISO/IEC 15189. Gjithashtu kujdeset për mirëvajtjen e procedurës së akreditimit të Trupave Inspektues dhe Certifikues sipas standardit SK ISO/IEC 17020, SK ISO/IEC 17024, SK ISO/IEC 17021, EN 45000 etj. Sektori për Akreditimin e laboratorëve udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili i raporton Drejtoratit të Akreditimit.

Sektori i Trajnimeve dhe Komunikimit me Organizatat Ndërkombëtare

Sektori i trajnimeve merret me trajnimin e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit si dhe organizimin e trajnimeve për nevojat e trajnimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit. Bën planifikimin vjetor të trajnimeve dhe përgatitjen e materialeve promovuese në lidhje me rëndësinë e akreditimit. Përgatit raporte mujore dhe vjetore për punën e DAK-së. Gjithashtu është pika kontaktuese dhe ndërlidhëse me organizatat Evropiane dhe Ndërkombëtare të Akreditimit.

Organet ndihmëse të DAK-së janë:

Këshilli Professional,
Këshilli i Akreditimit,
Komiteti Teknik i Laboratorëve Testues/Kalibruar,
Komiteti Teknik i Trupave Inspektues.

III. Aktivitetet e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK)

DAK ka të ngritur sistemin e menaxhimit sipas standardit ISO/IEC 17011 në bazë të cilit zhvillon edhe aktivitetin e saj. DAK kryen akreditimin e Laboratorëve testues/kalibruar, Trupave Inspektuese dhe Trupave Certifikuese bazuar në standardet e mëposhtme:

- Laborator testues/kalibruar sipas standardit SK ISO/IEC 17025,
- Laborator medicinal sipas standardit SK ISO/IEC 15189,
- Trupave Certifikuese të produkteve sipas kërkesave të standardit SK EN 45011,
- Trupave Inspektuese sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17020.

Qëllimi kryesor i DAK-së është që ta mirëmbajë dhe ta zhvillojë më tej akreditimin në Republikën e Kosovës, vazhdimisht duke zgjeruar fushën e akreditimit dhe duke rritur numrin e Trupave të akredituara (Laboratorëve testues, kalibruar dhe medicinal, Trupa Inspektuese dhe Trupave Certifikues). Ofron shërbimin e akreditimit si brenda territorit të Kosovës ashtu edhe jashtë saj duke respektuar politikat dhe rekomandimet e EA, IAF dhe ILAC. DAK-u vlerëson kompetencën teknike të TVK si në fushën e detyrueshme ashtu edhe në atë vullnetare.

Aktivitetet kryesore të DAK-së

- ✓ Të kryej monitorimin e rregullt vjetorë të TVK-ve të akredituara;
- ✓ Të pranohen aplikime të reja për procesin e akreditimit;
- ✓ Të bashkëpunoj me autoritetet e qeverisë për të zbatuar rregullat e reja teknike të harmonizuara me legjislacionin e BE-së;
- ✓ Të marrë masa për të siguruar sistem menaxhimi efektiv të DAK-së;
- ✓ Të siguroj mbështetje logjistike për punën e Këshillit të Akreditimit dhe ekspertëve që gjenden në listën e DAK-së;
- ✓ Kryen trajnime për fushën e akreditimit;
- ✓ Të siguroj masa për ti siguruar publicitet DAK-së për të promovuar akreditimin në vend dhe jashtë vendit;
- ✓ Përfaqëson Republikën e Kosovës në Organet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Akreditimit;
- ✓ Bashkëpunon me Ministrinë përkatëse dhe me shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit;
- ✓ Për t'ju ardhur në ndihmë laboratorëve DAK i informon vazhdimisht TVK mbi Testet e Zotësisë (PT) dhe Krahaset ndër laboratorike (ILC) që ofrohen nga organizmat evropiane dhe ato ndërkombëtare .
- ✓ Bashkëpunon me Organet Kombëtare të Akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, apo për të arritur marrëveshje dypalëshe;

Arritjet e DAK-së


Gjatë vitit 2013, DAK në mënyrë aktive mori pjesë në zbatimin e aktiviteteve të akreditimit, realizimin e vizitave vlerësuese që pritet mbyllja e jokonformiteteve, u realizuan mbikëqyrjet e TVK-ve të akredituara.

Për shkak të mosplotësimit të kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17025 kemi tërhequr akreditimin e dy Laboratorëve Testues. Në procedurë të vlerësimit janë TVK-të që kanë sjell dokumentacionin dhe pritet shpejt vlerësimi i tyre.

Paraqitja në formë tabelore e Aktiviteteve gjatë vitit 2013.

1	Akreditimet	7
2	*Realizimi i vizitave vlerësuese	2
3	Mbikëqyrjet	15
4	Tërheqje të akreditimit të LT	2
5	TVK-të në procedure e vlerësimit	5

Paraqitja në formë grafike e Aktiviteteve gjatë vitit 2013.




Në DAK, janë të akredituara 23 Trupa të Vlerësimit të Konformitetit.

Paraqitja në formë tabelore e TVK-ve të akredituar nga DAK-ja, në periudhën katërvjeçare 2010-2013

Numri rendor	TVK të akredituara sipas standardit	Numri i TVK të akredituara
1	Laborator testues (LT) KS EN ISO/IEC 17025	20
2	Laborator kalibrues (LK) KS EN ISO/IEC 17025	1
3	Trupa Inspektues (TI) KSEN ISO/IEC 17020	2

Paraqitja në formë grafike e TVK-ve të akredituar në periudhën katërvjeçare 2010-2013

Labororet e Akredituar gjate viteve 2010-2013



Nëntë vlerësimet që janë kryer gjatë vitit 2013 kanë rezultuar me akreditimin e shtatë Labororëve Testues:

1. **LT/35/25, N.P."IPE-PROING"**- Laboratori për analiza fiziko-mekanike i materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit, **11.02.2013**
2. **LT/51/26, NSH"Agrovet"**- Laboratori testues për materialet agrogjeologjike, agroekologjike, teknologjike, ushqim dhe ujë, **12.02.2013,**
3. **LT/50/27, Sharrcem "Titan Groop Company"**- Laboratori për analiza kimike dhe fiziko-mekanike te çimentos, **13.02.2013,**
4. **LT/45/28, SH.A "Birra-Peja"**- Laboratori për analiza kimike-fizike dhe mikrobiologjike të birrës, lëngjeve, ujit dhe çajit te ftotë, **02.07.2013**
5. **LT/53/29, N SH "Test & Ing"**- Laboratori i përzierjeve bituminoze dhe hulumtimeve gjeomekanike, **04.07.2013**
6. **LT/55/30, "Ex Fis LABS"SH.P.K** - Laboratori për analiza të naftës, **13.09.2013**
7. **LT/61/31, N.P.N. "Renelual Tahiri" Sh.p.k**- Laboratori i testimit të betonit produkteve të tij dhe përzierjes bituminoze , **04.12.2013**

Gjithashtu në bazë të planit të punës, DAK ka realizuar pesëmbëdhjetë mbikëqyrje të TVK-ve të akredituar:

1. **LT/16/008, Eskavatori Company Shpk**- Laboratori për analiza te agregateve dhe asfalteve,
2. **LT/18/011,"GEOKOS A&A"**- Laboratori i analizave gjeomekanike,
3. **LT/38/022, Fabrika për Prodhimin e Barnave Farmaceutike "Trepharm Laboratory"**- Laboratorin e kontrollit të cilësisë së produkteve farmaceutike,
4. **LT/06/014, "Vëllezërit e Bashkuar" sh.p.k**- Laboratori i materialeve të ndërtimit,
5. **LT/33/015, N.P.N"Ballkan projekt"**- Laboratori për shqyrtimin e materialit ndërtimor, baton, asfalt si dhe hulumtime gjeomekanike dhe gjeologjike te dherave
6. **LT/13/012, N.T.P "Ballkan Petroll"**- Laboratori i analizave te vajrave,
7. **LT/34/016, Korporata Fito sanitare „Sara & Meti“ sh.p.k,** Laboratori i mbrojtjes së bimëve dhe laborator bujqësor,

8. **LT/29/013, Qendra e Laboratorëve Testues-IKSHPK, me tre laboratorë:**
1.Laboratori për analiza të ujit të pijshëm dhe ujërave rekreativ, 2.Laboratori i kontrollit të cilësisë së ushqimit. 3.Laboratori mikrobiologjik i ushqimit dhe ujit,
9. **TI/ 41/18, Saybolt Pan Adriatika d.o.o, Njësia në Kosovë-** Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuar të naftës,
10. **LT/43/020, “ALDI CONSTRUCTION” SH.P.K-** Laboratorin për analiza të materialeve ndërtimore,
11. **LT/40/021, "SIERRA LAB" -** Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të naftës,
12. **LT/46/023, “ETL-Kosova”-**Laboratori për ekzaminimin e materiale ndërtimore dhe shqyrtimin e konstruksioneve nga betoni,
13. **LK/38/022, Laboratori “ERAMET”-**Laboratori për kalibrimin e masës dhe kalibrim të volumit,
14. **LT/42/024, "Kosova-Lab" -** Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës,
15. **LT/35/25N.P “IPE PROING”-**Laboratori për analiza fiziko-mekanike i materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit.

* Realizimi i dy vizitave vlerësuese në laboratorë testues që presim mbylljen e jokonformiteteve:

1. **LT/37/XX, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë- Laboratori i Ushqimit dhe Veterinës** me katër sektor: 1. Sektori i analizave të qumështit, 2. Sektori i mikrobiologjisë ushqimore, 3. Sektori i kimisë ushqimore dhe mbetjeve veterinare dhe 4. Sektori i aerologjisë.
2. **LT/56/XX, MBPZHR- Enti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë,** Laboratori Testues i Verërave.

Tërheqja e akreditimit është bërë tek laboratorët:

1. **LT/11/005, “FAN”Sh. p. k-** Laboratori për analiza të vetive mekanike për armature dhe njejve të saldimit, **Vendimi Nr: 002/2013** me 14.05.2013
2. **LT/12/009, “M&Sillosi” Sh.p.k-** Laboratori për analiza të miellit, grurit, himeve, brumërave, sneksit, vajit dhe bukës, **Vendimi Nr: 003/2013** me 24.07.2013

Gjatë vitit 2013, në DAK kemi pranuar 14 aplikacione të TVK-ve për akreditim.

IV. Objektivat dhe Aktivitetet në të ardhmen

Gjatë vitit 2013 si objektiv kryesor ka qenë mbyllja me sukses e jokonformiteteve të dhëna nga grupi i vlerësimit të EA-së. Me qëllim të arritjes së këtij synimi DAK ka ndërmarrë një sërë aktivitete të ndryshme dhe ka bërë ndryshime gjithëpërfshirëse si në legjislacion ashtu edhe në sistem të menaxhimit. Me ndihmën e Projektit Evropian të EA-së (European co-operation for Accreditation) nëpërmjet projektit gjerman PTB (Physikalisch-Technische Bundesanstalt) dhe ekspertës nga Greqia znj. Maria Papatzikou u rishikuan edhe njëherë të gjitha jokonformitetet u përgatit raporti i ri i zgjedhjes së jo-konformiteteve dhe i njëjti u pranua nga kryevlerësuesja e EA-së për DAK znj. Nicole Meurée-Vanlaethem e cila pastaj dërgoi raportin përfundimtar për zgjidhjen e jo-konformiteteve nga ana e DAK. Pas takimi të radhës të Komitetit për Marrëveshje Multilaterale të EA-së (EA-MAC) që u mbajt në Amsterdam të

Holandës ku në këtë takim u vendos që DAK të vlerësohet gjatë vitit 2014 (vlerësimi i plotë). Në momentin kur nënshkruhet marrëveshja e MLA-s (BLA) të gjitha Certifikatat e Vlerësimit të Konformitetit të lëshuara nga laboratorët e Akredituar nga DAK do të njihen nga të gjitha shtetet anëtare në EA dhe nënshkruese të MLA-së si dhe anëtare në IAF dhe ILAC.

Në raportin e fundit të progresit në Bruksel puna e Drejtorisë së Akreditimit është vlerësuar mirë dhe nuk kemi pasur asnjë sfidë për atë periudhë kohore.

Me datë 08.10.2013, DAK mori përgjigje pozitive lidhur me përfaqësimin e saj si vëzhgues në Komitetin e Menaxhimit të IAF për Marrëveshje Shumëpalëshe (IAF MLA Management Committee -MLA MC). Përfaqësues vëzhgues në IAF MLA MC do jetë z. Ibush Luzha.

Në përputhje me objektivat strategjike dhe politiken e cilësisë, aktivitete e DAK-së për vitin 2014 do të jenë të fokusuar në:

- Angazhim të më tejshëm për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave të DAK dhe të gjithë sistemit të akreditimit i cili do harmonizohet me praktikat e BE-se,
- Zgjerim të aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit bazuar në nevojat e palëve të interesit,
- Ngritjen e nivelit të kompetencës së të gjithë pjesëmarrëseve në procedure të akreditimit si të stafit permanent të DAK-së ashtu edhe të punonjëseve të jashtëm, dhe ngritjen profesionale të një numri më të madh të punonjëseve
- Rritjen e numrit kompetent të vlerësuesve dhe eksperteve teknik,
- Përmirësimin të bashkëpunimit me palët e interesit, (ministritë përkatëse, konsumatorët dhe TVK-ve të akredituara dhe asociacioneve të tyre) me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të të gjitha palëve të interesit,
- Promovim të vazhdueshëm të rëndësisë së akreditimit dhe rrolit të tij.

Bashkëpunimi me organizmat qeveritar të vendit

DAK-ja vazhdon bashkëpunimin e saj me organet e qeverisjes për zbatimin e procedurave të akreditimit për TVK, me organet përkatëse të qeverisë që japin autoritetin për zbatimin e rregullave teknike në sigurinë ushqimore, të produkteve industriale të sigurisë së mjedisit, shëndetësisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe fushave të reja tjera të interesit publik sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2011 “ Për Mënyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit “.


Bashkëpunimi në nivelin Evropian dhe Ndërkombëtarë i DAK-së

Drejtoria e Akreditimit të Kosovës, bashkëpunon me të gjitha organizmat akreditues të vendeve të Ballkanit dhe po punon për institucionalizimin e këtij bashkëpunimi duke nënshkruar disa Marrëveshje Bashkëpunimi:

1. Më 27 Mars 2008, DAK nënshkroi MoU-en me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) të Republikës së Shqipërisë.
2. Më 14 Maj 2009, DAK nënshkroi MoU-en me Institutin e Akreditimit nga Republika e Maqedonisë (IARM)

3. Më 19 Nëntor 2009, DAK nënshkroi MoU-en edhe me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK), Republikën e Turqisë
4. Më 26 Nëntor 2009, në Brugge të Belgjikës në Asamblenë Gjenerale të EA-së, DAK është anëtarësuar në EA (Europeanco-operation for Accreditation) si anëtare me Kontratë (Co-operation Member).
5. Më 17 Qershor 2010, DAK në Bruksel të Belgjikës nënshkroi MoU-en me Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA), Republika e Kroacisë.
6. Më 27 Korrik 2010, DAK është anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve ILAC International Laboratory Accreditation Cooperation).
7. Më 02 Gusht 2010, DAK është anëtarësuar në Forumin Ndërkombëtarë të Akreditimit (IAF) (International Accreditation Forum).
8. Më 24 Nëntor 2011 në Varshavë të Polonisë Drejtoria e Akreditimit e Kosovës u bë anëtarë shok (associate member) me EA (Europeanco-operation for Accreditation).

Drejtorja e Akreditimit e Kosovës (DAK) edhe më tej vazhdon të ketë përparim në aspektin e bashkëpunimit rajonal. Kësaj radhe në Zyre të DAK më datë 29.03.2013, DAK arriti të nënshkruaj memorandum mirëkuptimit me Trupin Akreditues të Rumanisë RENAR (Romanian Accreditation Association). Memorandumin e Mirëkuptimit nga ana e RENAR e nënshkroi Presidenti, z.Fănel Iacobescu, Ph.D,Dr.h.c, ndërkaq nga ana e DAK-së nënshkroi Drejtori i DAK-së z.MSc Ibush Luzha. Nënshkrimi i këtij memorandumit të mirëkuptimit u bë me qëllim të këmbimit të vlerësueseve, krye vlerësuesve, eksperteve të njohurive dhe eksperiencës, të cilat ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve në DAK dhe në avancimin e më tejme të infrastrukturës së cilësisë në Kosovë.



Trajnimet e organizuara nga DAK

Drejtorja e Akreditimit e Kosovës (DAK) 19 shtator 2013, zhvilloi trajnim me temën “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues” SK EN ISO/IEC 17025: 2007. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, kryesisht ishin persona përgjegjës për implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit në laboratorë të akredituar dhe laboratorë që janë në procesin e vlerësimit.



Me 5 nëntor 2013, DAK-ja zhvilloi trajnimin e dytë me temën “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues” SK EN ISO/IEC 17025: 2007. Në trajnim morën pjesë 24 pjesëmarrës, pjesëmarrësit e trajnimit ishin persona përgjegjës që punojnë në laborator dhe ekspert të fushave të ndryshme.



Objektivat e trajnimeve, ishin njohja me kërkesat e menaxhimit kapitullit 4 dhe kërkesat e kompetencës teknike kapitulli 5 i standardit SK EN ISO/IEC 17025:2007

Lektore ishin përfaqësues të DAK-së.

Në fund të secilit trajnim të pranishmeve iu ndanë certifikata për pjesëmarrje në trajnim.

DAK gjithnjë e më shumë po arrin që të rris dhe përmirësoj kompetencën e stafit dhe vlerësuesve teknik nëpërmjet trajnimeve. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt pati edhe mbështetja e DAK-së nga projekti IPA 2008 dhe PTB.

Trajnimet të cilat u ndoqën nga stafi i DAK-se gjatë vitit 2013 janë:

Trajnimi nga IAF/ILAC për Komitetin Teknik të Trupave Inspektuese, është mbajtur me 30 dhe 31 prill në Frankfurt,

Trajnimi me temën: Bujqësia organike e BE-së, kriteret e akreditimit nga Organizmat Kombëtar, është mbajtur me 09 dhe 10 maj në Shkup,

Trajnimi për kërkesat e rregullores EU 305/2011 për materialet ndërtimore dhe dallimi mes rregulloreve CPD dhe CPR, është mbajtur nga data 17-19 qershor në Stamboll,

Trajnimi për standardin ISO/IEC 17021:2011, Vlerësimi i konformitetit-Kërkesat për trupat që kryejnë auditimin dhe certifikimin e sistemit të menaxhimit, është mbajtur me 24 dhe 25 shator në Zagreb,

Trajnimi për standardin ISO/IEC 17024:2012 “Kërkesat e përgjithshme për trupat që operojnë në certifikimin e personelit”, është mbajtur me 29 dhe 30 tetor në Tiranë,

Trajnimi për standardit ISO/IEC 19011: 2006 “Auditimi i brendshëm për sistemin e menaxhimit të TVK-ve”, është mbajtur me 13 dhe 14 nëntor në Tiranë.

Takimet rajonale të DAK-ut

Edhe gjatë vitit 2013, DAK vazhdoi me pjesëmarrjen aktive në takimet e ndryshme rajonale:

- Me 30.04-01.05.2013 pjesëmarrja në takimin e IAF, (Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit), në Frankfurt të Gjermanisë.
- Me 16 Maj pjesëmarrja në takimin me shtete e Evropës Jugperëndimore organizuar nga projekti PTB mbajtur në Split,
- Me 29 dhe 30 Maj Asamblesë Gjenerale (EA-GA) mbajtur në Paris të Francës.
- Me 29.08-04.10.2013, Proficiency Testing(PT), Ljubljana, Sloveni ku përveç përfaqësuesit të DAK morën pjesë edhe 4 laborator nga Republika e Kosovës.
- Me 2 dhe 3 tetor, pjesëmarrja në Komitetin për Marrëveshje Multilaterale të EA-së (EA-MAC) që u mbajt në Amsterdam të Holandës,
- Me 6.11.2013 deri më 10.11.2013 “Regional Conformity Assessment”, CROLAB, Opati, Kroaci.
- Me 20 dhe 21 nëntor, pjesëmarrja në takimin e Asamblesë Gjenerale (EA-GA) mbajtur në Oslo të Norvegjisë,

Aktivitetet e tjera të DAK-së

Drejtorja e Akreditimit e Kosovës në vazhdimësi të aktiviteteve të saja, përmes të së cilave jo vetëm se kontribuon direkt në ngritjen e infrastrukturës së cilësisë, implementimin dhe mirëmbajtjen e saj, por edhe bën promovimin e rëndësisë së akreditimit.

Me 12 qershor 2013, organizoi një manifestim rasti me qëllim të shënimit të Ditës Botërore të Akreditimit. Moto e këtij takimi ishte promovimi i akreditimit: “Një testim, një certifikim, një akreditim” ose „Një produkt i testuar njëherë, pranohet kudo”. Të pranishmeve nga drejtori i DAK-së, iu prezantua një material i shkurtër për të arriturat e DAK-së.

Në fund të takimit u prezantua materiali promovues i Organizatës Ndërkombëtare të Akreditimit.



Drejtorja e Akreditimit e Kosovës, me 19 dhjetor 2013 mbajti takime përmbyllës me përfaqësues të: Trupave të Vlerësimit të Konformitetit, Këshillit të Akreditimit, Komiteteve Teknike, Ekspert Teknik dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Të pranishmit u njoftuan për të arriturat e DAK-së gjatë vitit 2013.

Pas përfundimit të diskutimeve në mënyrë solemne u bë shpërndarja e certifikatave të akreditimit nga Drejtori i Përgjithshëm i DAK Osman Hajdini për shtatë laboratorë testues.



Rimëkëmbja ekonomike dhe ri-industrializimi i vendit nuk do të jetë i mundur pa infrastrukturën e duhur teknike ku institucionet ofrojnë shërbime për testime, matje dhe kalibrime të aparaturave me të cilat përcaktohet cilësia e produkteve.

Për zhvillim të suksesshëm DAK, duhet të sigurojë fonde të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, hapësira për burime njerëzore për kryerjen e vlerësimeve për akreditim.

Për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të aplikacioneve të reja për akreditimin e TVK dhe ngarkesës së punës, DAK ka parapa të angazhoj edhe dy punëtorë në sektorin për akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibruës. Numri i përgjithshëm i të punësuarve tani është shtatë (7).

Punonjësit e rinj do të përfshihen në programet e trajnimit intensiv për tu aftësuar për kryerjen e procedurave të vlerësimit për akreditim të TVK-ve.